



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RREGULLA NR. XX/2020

RREGULLA PËR INTEGRITETIN DHE TRANSPARENCËN E TREGUT TË ENERGISË ME SHUMICË

Prishtinë
Shkurt 2020

Përmbajtja

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi	3
Neni 2.....	3
Përkufizimet dhe interpretimet	3
Neni 3 Ndalimi i tregtimit nga personat e brendshëm.....	7
Neni 4 Detyrimi për të publikuar informacionin e brendshëm.....	9
Neni 5 Ndalimi i Manipulimit të Tregut.....	10
Neni 6 Monitorimi i tregut	10
Neni 7.....	11
Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut.....	11
Neni 8 Mbrojtja e të dhënave.....	11
Neni 9.....	11
Besueshmëria Operacionale	11
Neni 12 Detyrimet e personave që profesionalisht rregullojnë transaksionet.....	12
Neni 13 Bashkëpunimi në Komunitetin e Energjisë dhe në nivel kombëtar	12
Neni 14 Sekreti profesional	14
Neni 15 Zbatimi i ndalimeve ndaj abuzimit të tregut.....	15
Neni 16 Afatet për Marrjen e Vendimit	15
Neni 17	16
E drejta e ankesës.....	16
Neni 18 Masat administrative dhe Gjobat	16
Neni 19 Faktorët lehtësues gjatë shqiptimit të masave administrative dhe gjobave.....	17
Neni 20	18
Ndryshimet.....	18
Neni 21	18
Interpretimi	18
Neni 22	18
Hyrja në fuqi	18

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me, Nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafin 1 nënparagrafi 1.12, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenin 54, Nenin 55, Nenin 56 dhe Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, në seancën e mbajtur me **XX.XX.XX**, miratoi:

RREGULLEN PËR INTEGRITETIN DHE TRANSPARENCËN E TREGUT TË ENERGJISË ME SHUMICË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Kjo Rregull përcakton kriteret që ndalojnë praktikatat abuzive që ndikojnë në tregjet e energjisë me shumicë, të cilat janë koherente me funksionimin e duhur të këtyre tregjeve me shumicë të energjisë, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.
2. Rregulla po ashtu parashikon monitorimin e tregjeve të energjisë me shumicë nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).
3. Kjo Rregull zbatohet për tregtimin e produkteve me shumicë të energjisë.
4. Kjo Rregull nuk cenon aplikimin e legjislacionit të Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionit kombëtar të konkurrencës ndaj praktikave që përfshihen në këtë Rregullore.
5. ZRRE dhe, aty ku është e përshtatshme, autoritetet kombëtare të konkurrencës dhe autoritetet e tjera relevante kombëtare bashkëpunojnë për të siguruar që një qasje e koordinuar është marrë për zbatimin e kësaj rregulle, ku veprimet ndërlidhen për një ose më shumë produkte të energjisë me shumicë, në të cilat zbatohen Nenet 3, 4 dhe 5 të kësaj Rregulle.
6. ZRRE është e detyruar që të bashkëpunoj me organet kompetente gjyqësore, dhe organet tjera në çështjet që kanë të bëjnë me çrregullimin e tregut me shumicë në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Informacion i brendshëm** - do të thotë informacioni i një natyre të saktë që nuk është bërë publik, që lidhet direkt ose indirekt me një ose më shumë produkte të energjisë me shumicë dhe që, nëse është bërë publik, ka të ngjarë të ndikojë ndjeshëm në çmimet e atyre produkteve të energjisë me shumicë.
 - 1.2. **Dokument** – do të thotë çdo dokument apo send tjetër i përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhëniet juridike.

1.3. Për qëllimet e këtij përkufizimi, **informacion** do të thotë:

- 1.3.1. informacionet që kërkohet të bëhen publike në përputhje me Ligjin për Energjinë (Nr. 05/L -081), Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L – 084), Ligjin për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085), Ligjin për Gazin Natyror (Nr.05/L-082) dhe Ligjin për Qasja në Dokumentet Publike (Nr. 05/L-082) duke përfshirë udhëzimet dhe kodet e rrjetit të miratuara në përputhje me ato Rregullore;
- 1.3.2. informacion në lidhje me kapacitetin dhe përdorimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen, konsumin ose transmetimin e energjisë elektrike ose të gazit natyror ose lidhur me kapacitetin dhe përdorimin e objekteve të GNL-së, përfshirë mungesën e disponueshmërisë së planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve;
- 1.3.3. informacionet që kërkohet të zbulohen në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullative në Komunitetin e Energjisë ose në nivel kombëtar, rregullat e tregut dhe kontratat ose parimet në tregun përkatës të energjisë me shumicë, përderisa ky informacion ka të ngjarë të ketë një efekt mbi çmimet e produkteve me shumicë të energjisë;
- 1.3.4. informacione të tjera që një pjesëmarrës tregu do të mund të përdorte si pjesë e bazës së vendimit të tij për të hyrë në një transaksion në lidhje me ose për të lëshuar një urdhër për të tregtuar një produkt të energjisë me shumicë; dhe
- 1.3.5. Informacion do të konsiderohet të jetë i një natyre të saktë nëse tregon një sërë rrethanash që ekzistojnë ose mund të pritët të shfaqen në mënyrë të arsyeshme, ose një ngjarje që ka ndodhur ose mund të pritët të ndodh, dhe nëse është mjaft e specifikuar për të mundësuar nxjerrjen e një konkluzioni lidhur me efektin e mundshëm të atyre rrethanave ose ngjarjeve në çmimet e produkteve me shumicë të energjisë;

1.4. **Manipulimi i tregut** - do të thotë:

- 1.4.1. të hyjë në ndonjë transaksion ose të lëshojë ndonjë urdhër për tregtimin e produkteve të energjisë me shumicë, i cili:
 - i. jep ose ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose çorientuese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë;
 - ii. siguron ose përpiqet të sigurojë, nga një person ose persona që veprojnë në bashkëpunim, çmimin e një ose disa produkteve me shumicë të energjisë në një nivel artificial, përveç nëse personi i cili ka hyrë në transaksion ose ka lëshuar urdhrin për tregti ka arsye të ligjshme për ta bërë këtë dhe se ky transaksion ose urdhër për tregti përputhet me praktikatat e pranuar të tregut në tregun e energjisë me shumicë në fjalë; ose
 - iii. përdor ose tenton të përdorë një pajisje fiktive ose ndonjë formë tjetër të mashtrimit ose konstruksionit, që jep, ose mund të japë, sinjale të rreme ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë; ose

- 1.4.2. shpërndarjen e informacionit përmes mediave, duke përfshirë internetin ose me çfarëdo mjeti tjetër, i cili jep ose ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose çorientuese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë, duke përfshirë shpërndarjen e thashethemeve dhe lajmeve të rreme ose mashtruese, ku personi që e ka shpërndarë e dinte, ose duhet ta kishte ditur, se informacioni ishte i rremë apo mashtrues.
- 1.5. Kur informacioni shpërndahet për qëllime gazetareske ose shprehje artistike, shpërndarja e informacionit do të vlerësohet duke marrë parasysh rregullat që rregullojnë lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në mediat e tjera, përveç nëse:
- 1.5.1. ata persona kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një avantazh ose fitime nga shpërndarja e informacionit në fjalë; ose
- 1.5.2. zbulimi ose shpërndarja bëhet me qëllim të çrregullimit të tregut në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë;
- 1.6. Përpjekje për të manipuluar tregun - do të thotë:**
- 1.6.1. të hyjë në ndonjë transaksion, duke lëshuar ndonjë urdhër për të tregtuar ose ndërmarrë ndonjë veprim tjetër në lidhje me një produkt energjie me shumicë me qëllimet e mëposhtme:
- i. dhënia e sinjaleve false ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë;
 - ii. sigurimin e çmimit të një ose disa produkteve të energjisë me shumicë në një nivel artificial, përveç nëse personi që ka hyrë në transaksion ose ka lëshuar urdhrin për tregti, vërteton se arsyet e tij për ta bërë këtë janë të ligjshme dhe se transaksioni ose urdhri për tregtim përputhet për praktikatat e pranuar të tregut në tregun e energjisë me shumicë në fjalë; ose
 - iii. përdorimi i një pajisjeje fiktive ose ndonjë forme tjetër mashtrimi ose pajisjeje që jep, apo mund të japë, sinjale false ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve me shumicë të energjisë; ose
- 1.6.2. shpërndarjen e informacionit përmes mediave, duke përfshirë internetin ose me ndonjë mjet tjetër me qëllim të dhënies së sinjaleve false ose mashtruese në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë;
- 1.7. Produkte me shumicë të energjisë - nënkupton kontratat dhe dokumentet që janë derivat i tyre, pavarësisht se ku dhe si tregtohen:**
- 1.7.1. kontratat për furnizimin me energji elektrike ose gaz natyror, kur dërgesa është në Palët Kontraktuese;
- 1.7.2. kontratat që lidhen me transportin e energjisë elektrike ose gazit natyror në Palët Kontraktuese;
- 1.8. Kontratat për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike ose gazit natyror për shfrytëzim nga konsumatorët fundor - nuk janë produkte të energjisë me shumicë. Megjithatë, kontratat për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike ose të gazit**

natyror tek konsumatorët fundor me një kapacitet konsumi më të madh se pragu i përcaktuar në pikën 1.8 do të trajtohen si produkte energjie me shumicë.

- 1.9. **Kapaciteti i konsumit** - nënkupton konsumin e konsumatorit fundor të energjisë elektrike ose të gazit natyror në shfrytëzim të plotë të kapacitetit të atij konsumatori. Ai përfshin të gjithë konsumin nga ai konsumator si një njësi ekonomike e vetme, për aq sa konsumi bëhet në tregjet me çmime të ndërlidhura me shumicë.
- 1.10. Për qëllime të përkufizimit nën pikën 1.9 të këtij Neni konsumi në impiantet individuale nën kontrollin e një njësie ekonomike të vetme që ka një kapacitet konsumi më të vogël se 600 GWh në vit, nuk do të merret parasysh, përderisa këto impiante nuk ushtrojnë ndikim të përbashkët në çmimet e tregut të energjisë me shumicë për shkak të vendosjes së tyre në tregje të ndryshme përkatëse gjeografike;
- 1.11. **Sektori i energjisë**- aktivitete të cilat përfshijnë prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, transportin, depozitimin, shitjen, rishitjen, blerjen dhe furnizimin e energjisë;
- 1.12. **Treg i energjisë me shumicë** - nënkupton çdo treg brenda Palëve Kontraktuese në të cilat tregtohen produkte të energjisë me shumicë;
- 1.13. **Pjesëmarrës i tregut** - nënkupton çdo person fizik apo juridik, duke përfshirë operatorët e sistemit të transmisionit dhe të shpërndarjes, i cili hyn në transaksione, duke përfshirë vendosjen e urdhrave për tregti, në një ose më shumë tregje të energjisë me shumicë;
- 1.14. **Person** - nënkupton çdo person fizik ose juridik;
- 1.15. **Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)** - është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
- 1.16. **Autoritet Publik** - çdo organ, autoritet ekzekutiv qeveritar, ministri, organ publik, departament, agjenci, ose autoritete të tjera të ngjashme që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, ligjdhënëse, rregullative, administrative ose gjyqësore në territorin e Kosovës.
- 1.17. **Operator i Sistemit të Transmetimit** - personi fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;
- 1.18. **Ndërmarrje** - çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist.
- 1.19. **Ndërmarrje e lidhur** - nënkupton një filial ose një ndërmarrje tjetër në të cilën mbahet një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e lidhur me një sipërmarrje tjetër;
- 1.20. **Operatori i Sistemit të Transmetimit të gazit natyror** – person fizik apo juridik që kryen funksionin e transmetimit dhe që është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar, përfshirë edhe

interkonekcionet e mundshme me sistemet tjera, dhe për garantimin e aftësinë afatgjate të sistemit për të plotësuar kërkesë për transmetimin e gazit natyror;

- 1.21. **Shpërndarja e gazit natyror** - person fizik apo juridik që kryen funksionet e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, në një zonë të caktuar përfshirë edhe interkonekcionet e mundshme me sisteme tjera dhe për garantimin e aftësinë afatgjate të sistemit për të plotësuar kërkesën për shpërndarjen e gazit natyror;
- 1.22. **Shpërndarja e energjisë elektrike** - personi fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- 1.23. **Pozitë Dominuese** - pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët;
- 1.24. **Infrastrukturë kritike** - nënkupton një aset, sistem ose pjesë të saj të domosdoshme për mirëmbajtjen e funksioneve jetike dhe sociale, shëndetin, sigurinë, mirëqenies ekonomike ose sociale të njerëzve, dhe çrregullimi ose shkatërrimi i së cilës do të kishte një ndikim të konsiderueshëm në Republikën e Kosovës ose në ndonjë Palë Kontraktuese si rezultat i mos mbajtjes së këtyre funksioneve.
- 1.25. **Informacion i ndjeshëm i lidhur me mbrojtjen e infrastrukturës kritike** - do të thotë faktet në lidhje me një infrastrukturë kritike, i cili nëse zbulohet mund të shfrytëzohet me qëllim për të shkaktuar çrregullimin apo shkatërrimin e instalimeve në infrastrukturën kritike;
- 1.26. **Informata konfidenciale** – do të thotë të dhëna, dokumente apo informacione të tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e aktiviteteve të energjisë që nuk janë më në domenin publik dhe që shpallja e tyre mund t'i vë në rrezik interesat komerciale të subjektit fiziki apo juridik; dhe
- 1.27. **Palët Kontraktuese** – do të thotë Palët Kontraktuese sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

KREU II

NDALIMI I TREGTIMIT DHE DETYRIMI PËR PUBLIKIM TË TË DHËNAVE

Neni 3

Ndalimi i tregtimit nga personat e brendshëm

1. Kushdo që në mospajtim me detyrat e tij për të mbrojtur informatat e brendshme të cilat i mëson gjatë kryerjes së aktivitetit ekonomik ose sipas detyrës zyrtare, i kumton personit të paaautorizuar informatën e panjohur për publikun dhe që mund të ndikoj në produkt me shumicë të energjisë ose kushdo që në ndonjë mënyrë tjetër përdor informatën e tillë për dobi personale

ose për qëllim të avantazhit të padrejtë në tregun e energjisë me shumicë për ndonjë person fizik apo juridik e ka të ndaluar sipas kësaj Rregullore dhe Legjislacion penal në fuqi.

2. Personat që posedojnë informacion të brendshëm në lidhje me një produkt me shumicë të energjisë, e kanë të ndaluar që të:
 - 1.1. përdorin këtë informacion për të blerë ose për të shitur, ose duke u përpjekur për të blerë ose disponuar, për llogari të tyre ose për llogari të një pale të tretë, direkt ose indirekt, produktet e energjisë me shumicë të cilave u referohet ky informacion;
 - 1.2. zbulojnë këtë informacioni tek çdo person tjetër përveç rasteve kur zbulimi i tillë bëhet në rrjedhën normale të ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave të tyre;
 - 1.3. të rekomandojnë ose të nxisin një person tjetër, në bazë të informacionit të brendshëm, që të blejë ose të siguroj produktet e energjisë me shumicë rreth të cilave ai informacion është i ndërlidhur.
3. Ndalimi i përcaktuar në paragrafin 1 zbatohet për personat e mëposhtëm që posedojnë informacion të brendshëm në lidhje me një produkt energjie me shumicë:
 - 2.1. anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrjeje;
 - 2.2. personat me zotërimi në kapitalin e ndërmarrjes;
 - 2.3. personat që kanë qasje në informata nëpërmjet ushtrimit të punës, profesionit ose detyrave të tyre;
 - 2.4. personat që kanë fituar informacion të tillë nëpërmjet veprimtarisë kriminale;
 - 2.5. personat që e dinë, ose duhet ta dinë, se është informacion i brendshëm.

Pikat 1.1 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij Neni nuk zbatohen për operatorët e sistemit të transmissioinit kur blejnë energji elektrike ose gaz natyror për të siguruar funksionimin e sigurt të sistemit.

4. Ky nen nuk zbatohet për:
 - 3.1. transaksionet e përfunduara gjatë kryerjes së një detyrimi që është bërë për shkak të blerjes ose shitjes së produkteve me shumicë të energjisë kur ky detyrim vjen si pasojë e një marrëveshjeje të lidhur, ose një urdhër për tregtimin, i vendosur përpara se personi në fjalë të ketë në posedim informacione të brendshme;
 - 3.2. transaksionet e lidhura nga prodhuesit e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, operatorët e deponimit të gazit natyror ose operatorët e objekteve të importit të GNL-së, qëllimi i vetëm i të cilit është mbulimi i humbjes së menjëhershme fizike që rezulton nga ndërprerjet e paplanifikuara, ku mosndërmarrja e një veprimi të tillë do të ndikonte që pjesëmarrësi i tregut të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet kontraktuale ekzistuese ose kur veprimi i tillë është ndërmarrë në marrëveshje me operatorin e sistemit të transmissioinit në fjalë për të siguruar funksionimin e sigurt të sistemit. Në një situatë të tillë, informacioni përkatës në lidhje me transaksionet duhet të raportohet tek ZRRE. Ky detyrim i raportimit nuk cenon detyrimin e përcaktuar në nenin 4 paragrafi 1 të këtij Neni;

- 3.3. pjesëmarrësit e tregut që veprojnë sipas rregullave emergjente kombëtare, ku autoritetet kombëtare kanë ndërhyrë për të siguruar furnizimin me energji elektrike ose gaz natyror dhe mekanizmat e tregut janë pezulluar në një Palë Kontraktuese ose pjesë të tyre. Në këtë rast, autoriteti kompetent për planifikimin emergjent duhet të sigurojë publikimin në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulle.
5. Kur personi i cili posedon informacion të brendshëm në lidhje me një produkt energjie me shumicë është një person juridik, ndalimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij Neni do të zbatohen gjithashtu për personat fizik që marrin pjesë në vendimin për të kryer transaksionin për llogari të personit juridik në fjalë.
6. Kur informacioni shpërndahe për qëllime gazetareske ose shprehje artistike, shpërndarja e informacionit do të vlerësohet duke marrë parasysh rregullat që rregullojnë lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në media të tjera, përveç nëse:
- 5.1. këta persona kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi ndonjë avantazh ose përfitim nga shpërndarja e informacionit në fjalë; ose
- 5.2. zbulimi ose shpërndarja bëhet me qëllim të çrregullimit të tregut në lidhje me furnizimin, kërkesën ose çmimin e produkteve të energjisë me shumicë.

Neni 4

Detyrimi për të publikuar informacionin e brendshëm

1. Pjesëmarrësit e tregut duhet të publikojnë në mënyrë efektive dhe me kohë, informacionin që ata posedojnë në lidhje me biznesin ose objektet të cilat pjesëmarrësi i tregut në fjalë, ndërmarrja e tij mëmë ose ndërmarrja e lidhur, zotëron ose kontrollon ose për çështjet operacionale për të cilat pjesëmarrësi në treg ose ndërmarrja është përgjegjëse, qoftë tërësisht ose pjesërisht. Shpalosja e tillë do të përfshijë informacione relevante për kapacitetin dhe përdorimin e objekteve për prodhimin, magazinimin, konsumin ose transmetimin e energjisë elektrike ose të gazit natyror ose në lidhje me kapacitetin dhe përdorimin e objekteve të GNL-së, duke përfshirë disponueshmërinë e planifikuar ose të paplanifikuar të këtyre objekteve.
2. Një pjesëmarrës tregu mund të vonojë, nën përgjegjësinë e vet, dhënien publike të informacionit të brendshëm, në mënyrë që të mos paragjykojë interesat e tij legjitime, me kusht që veprimi i tillë të mos mashtrojë publikun dhe me kusht që pjesëmarrësi i tregut të jetë në gjendje të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni dhe të mos marrë vendime në lidhje me tregtimin e produkteve të energjisë me shumicë bazuar në atë informacion. Në një situatë të tillë, pjesëmarrësi i tregut pa shtyrje të mëtejme do të sigurojë publikimin e informacionit, së bashku me arsyetimin për vonesën e publikimit të tij tek ZRRE.
3. Kurdo që një pjesëmarrës tregu ose një person i punësuar ose që vepron në emër të një pjesëmarrësi të tregut, zbulon informacionin në lidhje me një produkt energjie me shumicë gjatë ushtrimit të zakonshëm të profesionit ose detyrave të tij, siç referohet në pikën 2 të Nenit 3 (1) të këtij Neni, pjesëmarrësi i tregut ose personi duhet të sigurojë zbulimin e menjëhershëm, të plotë dhe efektiv të atij informacioni tek publiku. Në rast të një zbulimi jo të qëllimshëm, pjesëmarrësi i tregut do të sigurojë zbulimin e plotë dhe efektiv të informacionit publik sa më shpejt që të jetë e mundur pas zbulimit jo të qëllimshëm. Ky paragraf nuk do të zbatohet nëse personi që merr informacion ka detyrimin e fshehtësisë, pavarësisht nëse detyrimi i tillë rrjedh nga ligji, rregulloret, statuti i shoqatës ose ndonjë kontratë.

4. Publikimi i informacionit të brendshëm, duke përfshirë formën e përmbledhur, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji Elektrike, Ligjin për Energji si dhe Ligjin për Gazin Natyror ose udhëzimet dhe kodet e rrjetit të miratuara në përputhje me Rregullat në fuqi, nënkuptojnë publikim të menjëhershëm, të plotë dhe efektiv.
5. Kur një operator i sistemit të transmetimi është i liruar nga publikimi i disa të dhënave, në përputhje me Rregulloren (KE) Nr 714/2009 ose (EC) Nr 715/2009, ai operator është gjithashtu i liruar nga detyrimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni në lidhje me këto të dhëna.
6. Paragrafët 1 dhe 2 nuk cenojnë detyrimet e pjesëmarrësve të tregut sipas Direktivave 2009/72 / EC dhe 2009/73/EC, dhe Rregulloreve (KE) Nr 714/2009 dhe (EC) Nr 715/2009, përfshirë udhëzimet dhe kodet e rrjetit të miratuara në përputhje me ato Direktiva dhe Rregullore, veçanërisht në lidhje me kohën dhe mënyrën e publikimit të informacionit.
7. Paragrafët 1 dhe 2 nuk cenojnë të drejtën e pjesëmarrësve të tregut për të vonuar zbulimin e informacionit të ndjeshëm në lidhje me mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre, nëse është e klasifikuar në vendin e tyre sipas legjislacionit kombëtar në fuqi.

Neni 5

Ndalimi i Manipulimit të Tregut

Çdo përfshirje në, apo përpjekje për t'u përfshirë në manipulimin e tregut në tregjet me shumicë të energjisë do të ndalohe.

KREU III

MONITORIMI DHE REGJISTRIMI I PJESËMARRËSE NË TREG

Neni 6

Monitorimi i tregut

1. ZRRE do të monitorojë aktivitetin tregtar në produktet e energjisë me shumicë për të zbuluar dhe parandaluar tregtinë bazuar në informacionin e brendshëm dhe manipulimin e tregut në tregun e tyre kombëtar.
2. ZRRE do të bashkëpunojnë në nivel rajonal nëpërmjet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë në kryerjen e monitorimit të tregjeve me shumicë të energjisë të referuara në paragrafin 1 të këtij Neni.
3. Palët Kontraktuese mund tu ofrojnë autoriteteve të tyre kombëtare të konkurrencës ose një organi të monitorimit të tregut të krijuar brenda atij autoriteti për të kryer monitorimin e tregut me ZRRE-në. Në kryerjen e monitorimit të tillë të tregut, autoriteti kombëtar i konkurrencës ose organi i monitorimit të tregut do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ZRRE.
4. ZRRE, të paktën në baza vjetore, duhet t'i paraqesë Sekretariatit një raport për aktivitetet e tyre sipas kësaj Rregulloreje dhe ta publikojnë këtë raport.
5. Sekretariati do t'i raportojë Këshillit të Ministrave në baza vjetore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në informacionin e dhënë sipas paragrafit 3 të këtij Neni.

Neni 7

Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut

1. Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte me shumicë të energjisë ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes procedurave të tregtimit duhet të regjistrohen pranë ZRRE-së, ku bëhet dorëzimi i produkteve të energjisë me shumicë. Për qëllime të regjistrimit, ZRRE do të aplikojnë formatin e regjistrimit të hartuar nga Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve Evropian (ACER) sipas kësaj rregulle. Rregullatori do të publikoj në faqen elektronike formatin e regjistrimit.
2. Regjistrimi i pjesëmarrësve të tregut është pa paragjykim ndaj detyrimeve për të përmbushur rregullat e aplikueshme të tregtisë dhe balancimit.
3. Jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga afati i aprovimit të kësaj Rregullore, ZRRE do të krijojë regjistra kombëtarë të pjesëmarrësve të tregut të cilët do t'i mbajnë të azhurnuar. Regjistri duhet t'i japë secilit pjesëmarrës të tregut një numër identifikues unik dhe duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për të identifikuar pjesëmarrësin e tregut, duke përfshirë detajet përkatëse në lidhje me numrin e tatimit mbi vlerën e shtuar, vendin e themelimit, personat përgjegjës për vendimet operationale dhe tregtare dhe kontrolluesin ose përfituesin fundor të aktiviteteve tregtare të pjesëmarrësit të tregut. Rregullatori do të aplikojnë formatin e regjistrimit të hartuar nga ACER.
4. ZRRE do t'ia prezantojë informatat nga rexhistrat kombëtar Bordi Rregullativ të Komunitetit të Energjisë. Bazuar në informacionin e ofruar nga rregullatorët, Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë do të krijojë një regjistër qendror të pjesëmarrësve të tregut. Rregullatorët dhe autoritetet e tjera relevante do të kenë qasje në këtë regjistër.
5. Pjesëmarrësit e tregut nga paragrafi 1 i këtij neni do të dorëzojnë formularin e regjistrimit tek ZRRE përpara se të hyjnë në një transaksion me produktet e energjisë me shumicë.
6. Pjesëmarrësit e tregut të përmendur në paragrafin 1 do të komunikojnë menjëherë tek ZRRE çdo ndryshim që ka ndodhur në lidhje me informatat e dhëna në formularin e regjistrimit.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave

Kjo Rregull nuk do të paragjykojë detyrimet e Palëve Kontraktuese dhe rregullatorëve për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit komercialist të ndjeshëm, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave Personale në fuqi.

Neni 9

Besueshmëria Operacionale

1. ZRRE duhet të sigurojë konfidencialitetin, integritetin dhe mbrojtjen e informacionit të marrë në përputhje me Nenin 4 paragrafi 2 dhe Nenin 6 të kësaj Rregulle. ZRRE duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo keqpërdorim dhe qasje të paautorizuar në informacionin e mbajtur në sistemet e tyre. ZRRE, autoriteti kombëtar i konkurrencës dhe autoritetet e tjera përkatëse duhet të sigurojnë konfidencialitetin, integritetin dhe mbrojtjen e informacionit që ata marrin në përputhje me Nenin 4 paragrafi 2 dhe Nenin 7 paragrafi 1 të kësaj Rregulle, dhe duhet të ndërmarrin hapa për të parandaluar keqpërdorimin e një informacioni të tillë.

2. ZRRE mund të vendosë të publikojnë pjesë të informacionit që posedojnë, me kusht që informacioni i ndjeshëm komercial për pjesëmarrësit individual të tregut ose transaksionet individuale ose vendet e veçanta të tregut nuk zbulohet dhe nuk mund të nxirren përfundime.
3. ZRRE duhet të vënë në dispozicion bazën e të dhënave tregtare komercialisht jo të ndjeshme për qëllime shkencore, në përputhje me kërkesat e konfidencialitetit.

Neni 12

Detyrimet e personave që profesionalisht rregullojnë transaksionet

1. Çdo person që profesionalisht rregullon transaksionet në produktet e energjisë me shumicë që dyshojnë në mënyrë të arsyeshme se transaksioni mund të shkelë Nenin 3 dhe Nenin 5, do të njoftojë ZRRE-në pa vonesë të mëtejshme.
2. Personat që rregullojnë profesionalisht transaksionet në produktet me shumicë të energjisë, duhet të krijojnë dhe mbajnë rregulla dhe procedura efektive për të identifikuar shkeljet e parapara me Nenin 3 dhe Nenin 5 të kësaj Rregulle.

Neni 13

Bashkëpunimi në Komunitetin e Energjisë dhe në nivel kombëtar

1. ZRRE do të bashkëpunojë me rregullatorët e energjisë të palëve kontraktuese në kuadër të komunitetit të energjisë, duke përfshirë bashkëpunimin në nivel rajonal nëpërmjet Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë për qëllimet e kryerjes së detyrave të tyre në përputhje me këtë Rregullore.
2. ZRRE dhe autoriteti kombëtar i konkurrencës në një Palë Kontraktuese mund të krijojnë forma të përshtatshme të bashkëpunimit për të siguruar hetime efektive dhe efikase dhe për të kontribuar në një qasje koherente dhe të qëndrueshme ndaj hetimeve, procedurave gjyqësore dhe zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe ligjin përkatës financiar dhe të konkurrencës.
3. ZRRE pa vonesë do të informojnë Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit në mënyrë sa më specifike, kur ata kanë baza të arsyeshme për të dyshuar se veprimet në shkelje të kësaj Rregulloreje janë duke u kryer ose janë kryer në atë Palë Kontraktuese ose në një Palë tjetër Kontraktuese.
4. Kur ZRRE dyshon se aktet që kryhen në një Palë tjetër Kontraktuese janë duke ndikuar në tregjet e energjisë me shumicë ose çmimi i produkteve të energjisë me shumicë ndikon në ndonjë tjetër Palë Kontraktuese, ai mund të kërkojë nga Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariati të sigurojnë që kërkesat e kësaj rregulloreje të zbatohen në atë Palë Kontraktuese.
5. Për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj abuzimit të tregut në tregjet e energjisë me shumicë: ZRRE do të informojnë autoritetin kombëtar të konkurrencës të Palës së tyre Kontraktuese, Sekretariatit dhe Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë, kur ata kanë baza të arsyeshme për të dyshuar se ka akte që janë duke u kryer ose janë kryer në tregun e energjisë me shumicë, të cilat mund të përbëjnë shkelje të ligjit të konkurrencës.

6. Për të kryer funksionet e tij sipas paragrafit 1, kur, ndër të tjera, në bazë të vlerësimeve ose analizave fillestare, Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë dyshon se ka pasur shkelje të kësaj Rregulloreje, ai do të ketë të drejtë:
 - 6.1. të kërkojë nga një ose më shumë autoritete rregullative kombëtare që të ofrojnë çdo informacion në lidhje me shkeljen e dyshuar;
 - 6.2. të kërkojë nga një ose më shumë autoritete kombëtare rregullative që të fillojnë hetim për shkeljen e dyshuar dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura për të korrigjuar çdo shkelje të gjetur. Çdo vendim lidhur me veprimet e duhura që duhet të ndërmerren për të ndrequr çdo shkelje të gjetur është përgjegjësi e autoritetit kombëtar rregullativ përkatës;
 - 6.3. kur konsideron se shkelja e mundshme ka pasur ndikim ndërkufitar duhet të themeloj dhe koordinoj një grup hetues të përbërë nga përfaqësuesit e autoriteteve rregullative kombëtare përkatëse për të hetuar nëse kjo Rregullore është shkelur dhe në cilën Palë Kontraktuese ka ndodhur shkelja. Kur është e përshtatshme, Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë mund të kërkojë gjithashtu pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Agjencisë ose autoriteteve të tjera relevante të një ose më shumë Palëve Kontraktuese dhe/ose Shteteve Anëtare në grupin hetues.
7. Nëse ZRRE merr një kërkesë për informacion nga paragrafi 6 të këtij neni ose merr një kërkesë për fillimin e hetimit të një shkeljeje të dyshuar, menjëherë duhet të marrë masat e nevojshme për të përmbushur atë kërkesë. Nëse ZRRE nuk është në gjendje të japë informacionin e kërkuar menjëherë, do të njoftojë pa vonesë Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë për arsyet.
8. ZRRE mund të refuzojë të veprojë në një kërkesë kur:
 - 8.1. pranueshmëria mund të ndikojë negativisht në sovranitetin ose sigurinë e Palës Kontraktuese të adresuar;
 - 8.2. procedurat gjyqësore tashmë janë iniciuar në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona para autoriteteve të Palës Kontraktuese të adresuar; ose
 - 8.3. një gjykim final është dorëzuar në lidhje me personat e tillë për të njëjtat veprime në Palën Kontraktuese të adresuar.
9. Në një rast të tillë, ZRRE njofton Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë në përputhje me rrethanat, duke dhënë informacion sa më të detajuar për ato procedura ose gjykimin.
10. ZRRE do të merr pjesë në një grup hetimor të thirrur në përputhje me paragrafin 8 Nënparagrafi 8.3 të këtij Neni, duke dhënë të gjithë ndihmën e nevojshme. Grupi hetues i nënshtrohet koordinimit nga Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë.

KREU IV INFORMATAT KONFIDENCIALE

Neni 14 Sekreti profesional

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar në pajtim me këtë Rregull i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara me këtë Nen.
2. Detyrimi i fshehtësisë profesionale zbatohet për:
 - 2.1. personat që punojnë ose kanë punuar për një institucion të Komunitetit të Energjisë;
 - 2.2. auditorët dhe ekspertët e udhëzuar nga një institucion i Komunitetit të Energjisë;
 - 2.3. personat që punojnë ose që kanë punuar për autoritetet kombëtare rregullative ose për autoritetet e tjera përkatëse;
 - 2.4. auditorët dhe ekspertët e udhëzuar nga autoritetet kombëtare rregullative ose nga autoritetet e tjera përkatëse që marrin informacion konfidencial në përputhje me këtë Rregullore.
3. Informatat konfidenciale të marra nga personat e përmendur në paragrafin 2 të këtij Neni gjatë kryerjes së detyrave të tyre, nuk mund të zbulohen tek ndonjë person apo autoritet tjetër, përveç në formë të përmbledhur në mënyrë që një pjesëmarrës tregu individual ose tregu nuk mund të identifikohet, përjashtimisht rasteve të parapara me Kodin Penal, dispozitat e tjera të kësaj Rregulle ose legjislacioni tjetër relevant i Komunitetit të Energjisë.
4. Pa paragjykuar rastet e parashikuara nga Kodi Penal, ZRRE, organet ose personat të cilët marrin informacion konfidencial në pajtim me këtë Rregullmund ta përdorin atë vetëm në kryerjen e detyrave të tyre dhe për ushtrimin e funksioneve të tyre. Autoritetet, organet ose personat e tjerë mund ta përdorin atë informacion për qëllimin për të cilin u është ofruar atyre ose në kontekstin e procedurave administrative ose gjyqësore që lidhen posaçërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve.
5. Ky Nen nuk do të pengojë një autoritet në një Palë Kontraktuese që të shkëmbejë ose të transmetojë, në përputhje me ligjin kombëtar, informacionin konfidencial me kusht që ai të mos jetë marrë nga një autoritet i një Pale tjetër Kontraktuese ose nga Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë apo Sekretariati sipas kësaj Rregulle.
6. Përjashtimisht rasteve të cekura me këtë Nen, me kërkesë të gjykatës, institucionet dhe personat përgjegjës për mbajtjen e bazave të të dhënave, qoftë edhe pa pëlqimin e personave përkatës, i sigurojnë gjykatës të dhëna nga baza e tyre e të dhënave që i mbajnë, kur të dhënat e tilla janë të domosdoshme për zhvillimin e procedurave penale. Gjykata është e obliguar të mbrojë fshehtësinë e të dhënave të siguruara në mënyrë të tillë.

KREU I MBIKQYRJA DHE HETIMI

Neni 15

Zbatimi i ndalimeve ndaj abuzimit të tregut

1. Zyra e Rregullatorit për Energji, në përputhje me Nenin 56 të dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, do të ndërmerr masa hetimi, të cilat do të ushtrohen:
 - 1.1. në mënyrë direkte;
 - 1.2. në bashkëpunim me autoritetin e konkurrencës dhe autoritetet e tjera relevante; ose
 - 1.3. me kërkesë të organeve gjyqësore dhe të prokurorisë.

2. ZRRE, veprimet hetuese dhe zbatuese të përcaktuara me paragrafin 1 do të përfshijnë të drejtën:
 - 2.1. për qasje në ndonjë dokument përkatës në çdo formë, dhe të marrin një kopje të saj;
 - 2.2. për të kërkuar ndonjë informacion nga çdo person përkatës, përfshirë ata që përfshihen në mënyrë të vazhdueshme në transmetimin e urdhrave ose kryerjes së veprimeve në fjalë, dhe nëse është e nevojshme, të drejtën për të thirrur dhe dëgjuar ndonjë person të tillë;
 - 2.3. për të kryer inspektime në vendndodhje;
 - 2.4. për të kërkuar regjistrimet ekzistuese telefonike dhe të komunikimeve elektronike, pas kërkesës drejtuar Prokurorit të Shtetit dhe aprovimit të Gjykatës;
 - 2.5. për të kërkuar ndërprerjen e çdo praktike që është në kundërshtim me këtë Rregullore ose aktet e implementuara të miratuara në bazë të tyre;
 - 2.6. për të kërkuar nga gjykata për të ngrirë ose sekuestruar asetet deri në përfundimin e hetimit;
 - 2.7. për të kërkuar nga gjykata ose ndonjë autoritet kompetent të vendosë ndalim të përkohshëm të veprimtarisë.

Neni 16

Afatet për Marrjen e Vendimit

1. Vendimi për konstatimin e shkeljeve eventuale dhe vendimin për konstatimin e keqpërdorimit dhe abuzimit të tregut me shumicë, ZRRE e merr në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e vërtetimit të të gjitha fakteve relevante për marrjen e vendimit të tillë
2. ZRRE në raste të veçanta mund ta zgjasë afatin për marrjen e vendimeve edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë.
3. Të gjitha vendimit merren në mënyrë autonome dhe të pavarur nga çfarëdo organi politik apo publik, apo çfarëdo ndërmarrje publike apo private.
4. Vendimit brenda tridhjetë (30) ditësh do të publikohen në faqen zyrtare të ZRRE-së.

5. Të dhënat të cilat konsiderohen fshehtësi afariste do të përjashtohen nga publikimi sipas paragrafit 4 të këtij Neni.

Neni 17

E drejta e ankesës

1. Kundër vendimit të ZRRE-së, me të cilën konstatohet shkelja e kësaj Rregulle dhe shqiptimit të masave ndëshkuese si dhe vendimi me të cilën ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, nuk është e lejuar ankesa, mirëpo pala e pa kënaqur në afat prej (30) ditës, pas pranimit të vendimit mund të inicioj me padi konflikt administrativ në gjykatën kompetente në Republikën e Kosovës.
2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

KREU I

MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 18

Masat administrative dhe Gjobat

1. ZRRE në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin për Masat Administrative dhe Gjobat, do të ndërmerr masat ndëshkimore për shkeljet e kësaj Rregulle.
2. ZRRE mund të vendos masa administrative si në vijim:
 - 2.1. Të obligoj personin fizik dhe juridik që të ndërpres kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë sheqeje sipas kësaj Rregulle;
 - 2.2. Shpall të pavlefshëm çdo akt ose vendim që përbën shkelje, të anuloj dhe të shfuqizoj atë;
 - 2.3. Të obligoj personat fizik dhe juridik që të kryejnë të gjitha veprimet e arsyeshme që konsiderohen si të nevojshme për të eliminuar efektet negative, dhe shqiptimin e vërejtjeve;
 - 2.4. Të përcaktoj masa të përkohshme në lidhje me shkeljen e supozuar.
3. Pavarësisht masave administrative të përcaktuara me këtë Rregull, ZRRE mund të vendos edhe gjoba për personat fizik dhe juridik për shkeljet në pajtim me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, si në vijim:
 - 3.1. Nuk jep informata të kërkuara sipas kësaj Rregulle;
 - 3.2. Zbulon informata konfidenciale në mënyrë të papranueshme,
 - 3.3. Nuk jem ndihmën e kërkuar dhe nuk pranon të bashkëpunon me organet kompetente,
 - 3.4. Nuk vepron në pajtim me masat e imponuara për të parandaluar keqpërdorimin e pozitës dominuese,
 - 3.5. Mban llogari në mënyrë që nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi,
 - 3.6. Vepron në kundërshtim me këtë Rregullore dhe Legjislacionin në fuqi.

4. Për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij Neni, personit fizik dhe juridik do t'i shqiptohen gjoba nga (5,000.00 EURO) deri në shumën 10% të të ardhurave që ndërmarra ka akumuluar gjatë vitit paraprak.
5. Niveli i gjobës sipas paragrafit 4 të këtij Neni do të varet nga faktorët si në vijim:
 - 5.1. Vlera materiale e dëmit të shkaktuar;
 - 5.2. Numri i konsumatorëve të prekur,
 - 5.3. Përfitimet financiare nga veprimet e paligjshme të ndërmarra, dhe
 - 5.4. Ndikimi i shkeljes në funksionin e tregut të energjisë.
6. Gjatë shqiptimit të masës administrative dhe gjobës, ZRRE do të njoftoj me shkrim personat fizik dhe juridik për shkeljet e bëra dhe do t'iu jap mundësi dhe kohë që të përgjigjen me shkrim, brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi.
7. ZRRE pas pranimit të përgjigjeve me shkrim nga personat fizik dhe juridik do të vlerësoj ato dhe do të nxjerr vendimin përputhje me konstatimet dhe shkeljet e vërtetuara.
8. Nëse gjoba e shqiptuar nga ZRRE nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor, do të iniciohet procedura gjyqësore për pagesë të gjobës si borxh civil.
9. Masat administrative dhe gjobat e shqiptuara nga ana e ZRRE-së, nuk përjashtojnë përgjegjësinë civile dhe përgjegjësin penale sipas legjislacionit në fuqi.
10. ZRRE do të bëjë publike masat ose gjobat e shqiptuara sipas paragrafit 1 për shkelje të kësaj Rregulle, përveç nëse zbulimi i tillë do të shkaktonte dëme joproporcionale për palët e përfshira.
11. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij Neni do të paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 19

Faktorët lehtësues gjatë shqiptimit të masave administrative dhe gjobave

1. Faktorët që mund të konsiderohen si lehtësues gjatë shqiptimit të masave administrative apo gjobave për qëllime të kësaj Rregulle janë si në vijim:
 - 1.1. Personi fizik apo jurik është përpjekur që të parandaloj ose të pakësoj dëmin e shkatuar nga shkelja;
 - 1.2. Shkallën e dëmit që i është bërë subjektit fizik apo juridik;
 - 1.3. Sjelljet paraprake,
 - 1.4. Gjendjen financiare etj.

KREU II DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Ndryshimet

- 1 ZRRE mban të drejtën që ta ndryshoj ose ta modifikoj çdo dispozitë të kësaj Rregullore.
- 2 Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregullore do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 21

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi i ZRRE-së, do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar